



Planuar / Dorezuar Planned / Delivered	02.12.2020	viti god year	
Organ / Njësia Org. / Unit	Nr Prot Pr. No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHUK	2892/2020		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A. Nr.339/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.Nr.339/2020, të datës 02.11.2020, të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] me adresë banimin fsh. „Dardani“, Rr.„Mjalta“, nga Komuna e Ferizajt, kundër organit të punësimit Komuna e Ferizajt në çështjen juridike“ kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 02.12. 2020 mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A. Nr. 339/2020 të datës 02.11.2020, të parashtruar nga ankuesi [REDACTED].
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

A r s y e t i m

Drejtoria e Arsimit në Komunën e Ferizajt, me datë 20.07.2020, ka shpallur konkurs nr. 716 për pozitën „ Sekretar i Shkollës së Mesme Teknike „Pjetër Bogdani“, dhe „ Sekretar i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ultë “ Naim Frasheri”, në fshatin Zaskok, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi [REDACTED].

Drejtoria e Arsimit të Komunës se Ferizajt, me datë 15.09.2019, ka publikuar njoftimin Nr.548 për përzgjedhjen e kandidateve për pozitën „ Sekretar i Shkollës së Mesme Teknike „Pjetër Bogdani“, dhe „ Sekretar i Shkollës Filllore të Mesme dhe të Ultë, Naim Frasheri”, në fshatin Zaskok. Ankuesi ka atakuar këtë njoftim me ankesën 02-070/01-0076823/20 te datës 17.08.2020, në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Ferizajt (KZAK), i cili me vendimin me numër protokollli Nr. 02-070/01-0076823/20, te datë 02.10.2020, ka refuzuar ankesën e ankuesit [REDACTED] si të pa bazuar në ligj.

Ankuesi [REDACTED] [REDACTED] i pakënaqur me vendimin e KZAK-së me datën 02.11.2020, ka parashtruar ankesë me numër protokoli 2373/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore së Komuna e Ferizajt procedurat e rekrutimit për pozitat „Sekretar i Shkollës së Mesme Teknike „Pjetër Bogdani“, dhe „Sekretar i Shkollës Fillore të Mesme dhe të Ultë „Naim Frasheri“, në Zaskok, i ka zhvilluar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshilli ankesën e ankuesit e ka proceduar tek Komuna e Ferizajt, për përgjigje në ankesë me datë 05.11.2020, ndërsa me datën 26.11.2020 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Administrimi i provave- për vendosje të drejtë lidhur me çështjen, Kolegji ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr.339/2020, me numër protokoli 2373/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 02.10.2020 Nr. 02-070/01-0076823/të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; kërkesën për punësim të [REDACTED] [REDACTED] e datës 30.07.2020, Certifikatën e trajnimit të datës 10.09.2008 nga CISCO, Certifikatën e shtetësisë të datës 15.06.2020, Certifikatën nga Gjykata Themelore Ferizaj e datës 08.07.2020 për hetim dhe ndjekje penale, vërtetimin e datës 15.10.2018 mbi përvojën punës nga Konsulenca Juridike "Juridika"; Vërtetimin e datës 28.09.2019 të lëshuar nga Kolegji Evropina " JURIDICA", Vërtetimin e datës 08.12.2016 nr. Ref 101369 të Universitetit të Prishtinës " Hasan Prishtina" Diplomën e datës 08.07.2016; Konkursin e datës 20.07.2020; Pyetësorin e testit me shkrim i datës 21.08.2020, Vendimin e datës 24.07.2020 për Themelimin e Komisionit të Përzgjedhës, Regjistrin e kërkesave të aplikuarve nr. 416 datë 02.07.2020, Njoftimi i datës 19.08.2020 nr. 467 për intervistë me shkrim, Njoftimin për Intervistë nr.519 te datës 08.09.2020, Përmbledhjen e Vlerësimeve Individuale nr. Ref 416 të datës 08.309.2020; Vendimi i datës 15.09.2020; Nr. 548 për shpalljen e rezultateve të pranimit sipas konkursit, njoftimi i datës 10.11.2020; Përgjigjeje në ankesë e datës 26.11.2020, me numër protokoli 2777/2020, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe shqyrtimit të provave të dërguara nga palët, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi [REDACTED] [REDACTED], *sepse,*

Bazuar në Aktgjykimin Nr.ref.AGJ 1583/20 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se Ligji nr. NR. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë është i zbatueshëm nga data 09.07.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës dhe bazuar në dispozitat e Ligjit NR. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë ka konstatuar se pozita "Sekretar i Shkollës" nuk është pozitë e shërbyesit civil, por pozitë e Nëpunësit të Shërbimit Publik ashtu siç përcaktohet nën 2 paragrafi 4 të Ligjit NR. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë " *Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike.*



Bazuar nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për ankesat e nëpunësve Civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin civil, siç është përcaktuar edhe me nenin 2 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 si dhe nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet së: **Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.**

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A. Nr. 339/2020

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit [REDACTED]
- Kryetarit të Komunës së Ferizajt;
- Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Ferizajt;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Ferizajt;
- Arkivit të KPMSHCK-së

